



E K S T R A K T

Nga diskutimi publik lidhur me “Projektrregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës”, mbajtur më dt. 31.10.2024, me fillim në orën 10:00.

Takimin e hapi dhe e kryesoi z. Osman Bllaca.

Sadudin Hasani: - kryetar i Këshillit lokal, Zona Qendër Prishtinë – shtroi shqetësimin lidhur me 40 familje që jetojnë në Zonën qendër e jetojnë në kushte mjaft të rënda ekonomike. Prandaj ai kërkoi nga Komuna e Prishtinës që t’i subvencionojë ata duke i paguar qiratë atyre, si dhe duke i gjetur vendstrehim më të sigurtë ku nuk kanë probleme siç kanë këtu, si p.sh kur bie shi iu pikun tavanet etj. Ai në vazhdim ceku edhe objektet që janë problematike ku jetojnë këto familje, pra janë: tek stadiumi, në rrugën “Enver Zymeri”, në rrugën “Agim Ramadani”, në rrugën “Aleksandar Stipçevic”, në ç’rast propozoi që me u vizituar ato familje dhe të shihet vërtet gjendja e tyre.

Osman Bllaca: - duke iu përgjigjur zotëriut në fjalë tha se me sa e di unë ne iu kemi bërë një zgjidhje për shumicën prej tyre edhe kemi tentuar me i heq, ku tani nuk e di se a janë ata apo nuk janë, sepse janë edhe më tej ku është ai parkingu nëntokësor meqë ka pasur edhe aty.

Sadudin Hasani: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se tërheqja e tyre ka ndodhur për biznes e nuk ka ndodhur për me i rehabilituar ata, tërheqja e atyre familjeve tek Biblioteka ka ndodhur për me i hap rrugën biznesit që është bërë, të atyre lokaleve që janë të parkingut nëntokësor. Tek subvencionimi i bizneseve tha se ishte dashur me e pas një pasqyrë të bizneseve të vogla për me shikuar se në çfarë gjendje janë dhe me i subvencionuar, si dhe cilat kategori kanë më shumë nevojë për subvencionim e cilat jo.

Igballe Mustafa: – pyeti pse është numri kaq i vogël i qytetarëve në debat, a nuk janë të informuar apo çka është në pyetje.

Osman Bllaca: - duke iu përgjigjur znj. Mustafa tha se të gjithë janë të informuar për takimin e sotëm, varet nga interesimi i qytetarëve sepse kemi takime kur numri i qytetarëve është i madh.

Nëse nuk ka diçka tjetër për diskutim, atëherë e konsideroj të mbyllur këtë takim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim publik lidhur me ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës

31 tetor, 2024

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	SADUDI	HASANI			
2	Iqbalje	Mustafa			
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!